

RRETH ROMANIT “TË JETOSH NË ISHULL” TE AUTORIT BEN BLUSHI

NGA XHAVIT SHALA

Interviste për gazetën “Tirana Observer”¹

Pyetje e gazetës “Tirana Observer”: Romani “Të jetosh në ishull” i Ben Blushit është shoqëruar me shumë polemika ditët e fundit. Përse sa herë diskutohet për identitetin tonë kombëtar që lidhet edhe me fenë ka debate të tilla që na kujton debatin e famshëm mes Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qoses?

Xhavit Shala: Me romanin “Të jetosh në ishull”, autori, artistikisht është përpjekur të trajtojë ndërmjet të tjerave dhe dinamikën e besimeve fetare të shqiptarëve. Në të vërtetë, besimet fetare përbëjnë themelet e identitetit kombëtar të popujve. Identiteti kombëtar është i lidhur me qytetërimin dhe qytetërimet, përgjithësisht, kanë qenë dhe mbeten baza kryesore rreth të cilave krijohen aleanca të ndryshme politike, ekonomike e ushtarake, si dhe boshti i integritetit të shteteve. Prandaj, kur vjen diskutimi tek përkatësia fetare e shqiptarëve, debati “nxehet” pasi shpesh nënkuptohet dhe mundësia dhe lehtësia e pjesëmarrjes dhe integritetit të shqiptarëve në strukturat euroatlantike dhe shtrohet pyetja se cilit qytetërim i përkasim.

Por jo gjithmonë feja është përcaktuese për qytetërimin e një kombi dhe kjo duhet të qetësojë shpirtrat e trazuar të palëve në debat. Rrethanat historike bënë që në themel të identitetit kombëtar të shqiptarëve të mos jetë besimi fetar, por gjuha, kultura, tradita dhe ai, ndonëse u islamizua në një masë të konsiderueshme, nuk ju dëmtua në mënyrë të pakthyeshme identiteti dhe shpirti i tij perëndimor. Identiteti qytetëruar i shqiptarëve është në dinamikë dhe po ripërcaktohet drejt atij perëndimor. Elita politike dhe ekonomike e vendit tonë dhe i gjithë populli shqiptar e mbështesin hapur këtë ripërcaktim. Mbështetja që Evropa dhe Amerika i kanë dhënë Shqipërisë pas fillimit të proceseve demokratike, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit dhe ftesa për ta anëtarësuar në NATO tregojnë se edhe grupet dominuese në qytetërimin

¹ Intervista është botuar në rubrikën « Forum », të gazetës « Tirana Observer », me datë 30 Prill 2008

perëndimor janë të gatshme të përqafojnë ripërcaktimin e shqiptarëve drejt qytetërimit të tyre.

Pyetje e gazetës “Tirana Observer” : Komuniteti Mysliman Shqiptar në reagimin e tij ka deklaruar se në libër ka fyerje të parimeve fetare myslimane dhe cenon harmoninë fetare në Shqipëri. A mendoni ju se Ben Blushi në këtë libër ka bërë pikërisht këtë gjë?

Xhavit Shala: Nuk di dhe nuk besoj të ketë një reagim të tillë zyrtar nga ana e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Reagimet kanë qenë individuale dhe kjo është normale. Romani i Blushit është i Blushit dhe nuk përfaqëson ndonjë linjë zyrtare. Nuk mendoj se cenon harmoninë tonë fetare dhe raportet midis fjalës së lirë e lirisë fetare. Nëse do ta shohin historikisht procesin e islamizimit të një pjesë të popullsisë shqiptare gjatë shekujve do të vëmë re se kjo fe u përhap në përmasat që është sot si pasojë e pushtimit ushtarak osman, e shtrëngimit dhe e pranimit të kësaj feje nga një pjesë e popullsisë shqiptare. Kalimin në fenë islame e favorizuan edhe një sërë faktorësh, si ato të karakterit ekonomik, pozicioni gjeografik, niveli i pamjaftueshëm arsimor i popullsisë, roli nxitës që luajti bektashizmi, si variant liberal i fesë islame, si dhe zbehja e mbështetjes nga Roma për katolikët shqiptarë.

Pyetje e gazetes “Tirana Observer”: Ç’duhet të bëjë historia, letërsia dhe arti shqiptar në rastin e një periudhe të Shqipërisë jo pak të rëndësishme që nga viti 1600 deri në vitin 1900, e cila në tekstet zyrtare kalohet vetëm me disa fjali?

Xhavit Shala: Një diçka është e qartë. Nuk është faji i popullit që sot është më shumicë myslimane. Dhe askush në Evropë nuk na kërkon ne shqiptarëve që, nëse duam të pranohemi në BE, duhet të heqim dorë nga myslimanizmi e të bëhemi të krishterë. Tolerancën dhe koloritin tonë fetar Evropa e quan një vlerë tonën mjaft pozitive, vlerë e cila do të na ndihmojë t’i bashkangjitemi familjes së përbashkët evropiane. Prandaj është e domosdoshme ruajtja dhe promovimi i kësaj vlere. Këtë duhet të pasqyroje dhe historia dhe letërsia e arti shqiptar.